



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM BERAT**

Berat, më 21.05.2025

**N J O F T I M
PËR VEND VAKANT NË POZICIONIN SEKRETAR PRANË PROKURORËVE**

**NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË
PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM BERAT**

Në mbështetje të Ligjit nr 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të Ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, shpall konkurrimin për nëpunës civil për pozicionin e punës:

- Sekretar pranë Prokurorëve 1 (një)

Për pranimin në shërbimin civil, kandidati duhet të plotësojë **kërkesat e përgjithshme** sipas nenit 21, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si më poshtë:

1. Kushte të përgjithshme

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këti ligji.

- Kushtet e veçanta për pozicionin "Sekretar pranë Prokurorëve"

- Të ketë mbaruar studimet e larta në Drejtësi (3+2), ose i barazvlefshëm me të, vërtetuar me diplomën dhe listen e notave përkatëse
- Të ketë njohuri të mira në kompjuterin, vërtetuar me dokumentin përkatës
- Të ketë njohuri të mira gjuhësore e drejtshkrimi
- Të ketë njohuri të mira minimalisht të një gjuhe të huaj,

- Të ketë përvojë profesionale minimalisht për një periudhë një vjeçare në profesionin e juristit ose çdo lloj përvoje tjerër që lidhet me prokurorinë.
- Të prezantojë etikë, qytetari dhe nivel performancë të denjë për institucionet shtetërore dhe të pranojë e realizojë testimin bazë që përfshin komunikim të lirë me komisionin.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 05.06.2025 ora 16:00

Vendi i dorëzimit të dokumentave: Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë Kryesekretarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, çdo ditë punë duke filluar që prej datës 22.05.2025 ora 08:00 deri më datë 05.06.2025, ora 16:00.

Konkurrimi i hapur për vendin e punës së mësipërm, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat do të bazohet në:

1. *Ligjin nr. 97/2016, "Për organizimin e funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"*
2. *Ligjin nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar,*

Konkurrimi do të zhvillohet në dy faza:

1. Faza e parë:

- Verifikimi paraprak i kandidatëve për plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe atyre të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim
- Komisioni i pranimit në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e mbylljes së pranimit të tyre, do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim. Kandidatet që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik e cila administrohet nga Komisioni dhe do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe në hyrjen kryesore të Prokurorisë Berat.
- Kandidatet, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, renditen në një listë të veçantë në të cilën regjistrohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk publikohet dhe administrohet nga Komisioni, i cili njofton në mënyrë individuale kandidatët që nuk janë kualifikuar.
- Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtuesit të Prokurorisë Berat, brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga data e shpalljes së listës. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga data e depozitimit të ankesës

II. Faza e dytë përbëhet nga vlerësimi i kandidatëve që përfshin:

- Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore
- Vlerësimi me shkrim.

- Intervista e strukturuar me gojë.

-Dokumentacioni i kërkuar i domosdoshëm për këtë pozicion

- Kërkesë me shkrim, ku të vendosen të dhëna mbi adresën e banimit, adresës elektronike të e-milit dhe numërin e telefonit,
- CV (Jetëshkrim) të detajuar,
- Fotokopje e letërnjoftimit / kartës së identitetit/ pasportës.
- Çertifikatë familjare
- Raport mjeko-ligjor
- Diploma përkatëse e studimeve dhe Lista e notave të noterizuara
- Dokumente të tjerë që tregojnë njohuri apo aftësi të vecanta
- Vërtetim për gjëndjen gjyqësore (Dëshmi penaliteti),
- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria
- Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja

Për informacion të mëtejshëm kandidatët mund të paraqiten pranë Kryesekretarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Njoftimi për kandidatët do të afishohet në mjediset e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, në vendin e njoftimeve si dhe në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore;
- Vlerësimi me shkrim;
- Intervista e strukturuar me gojë.
- Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:
- Për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore, **15 pikë**; - Për vlerësimin me shkrim, **60 pikë**.
- Për intervistën e strukturuar me gojë, **25 pikë**;
- Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët do të bëhet nëpërmjet adresave të e-mailit, me mesazhe në numrin e telefonit të kandidatit, në faqen e internetit dhe tek hyrja e Prokurorisë Berat.

Për më shumë informacion mund të vizitoni edhe faqen në internet: [ëëë.pp.gov.al](http://eeë.pp.gov.al).

**KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT NË
PROKURORINE PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM BERAT**

